



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 27 maj 2014**

**Numri i lëndës: 2013-26**

**Selami Taraku**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 maj 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhëns të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 26 nëntor 2013.

## **II. FAKTET**

2. Parashtresat e ankuesit mund të përmblidhen si në vijim.
3. Ankuesi ishte punëtor i Radio Televizionit të Prishtinës (RTP), e cila ka pushuar së vepruari në vitin 1999. Asetet e RTP-së, ndërmarrje shoqërore, tani administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), ndonëse objektet e tyre përdoren nga ana e Radio Televizionit të Kosovës (RTK).
4. Në një datë të pasaktësuar, RTP-ja ka parashtruar një padi kundër RTK-së dhe AKP-së në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar kthimin e ndërtave, objekteve dhe pronave të tjera, të cilat përdoren nga të paditurit. Gjithashtu ata kanë kërkuar kompensim për të ardhurat e humbura të ish-punëtorëve të RTP-së.
5. Më 26 prill 2010, Gjykata Komunale e ka miratuar këtë padi pjesërisht. Gjykata ka gjetur se RTP-ja ishte pronare e rreth njëzet parcelave të tokës të cekura në padi dhe ka urdhëruar që të paditurit t'i lironjë ato. Gjykata kishte hedhur poshtë padinë në lidhje me parcelat e tjera të tokës. Gjithashtu gjykata ka hedhur poshtë kërkesën për kompensimin e ish-punëtorëve të RTP-së si të pabazuar.
6. Me sa duket njëra palë apo të dy palët kanë paraqitur një ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, ndërsa procedurat janë ende të pazgjidhura. Po ashtu duket se ish punëtorët e tjerë të RTP-së kanë kontaktuar EULEX-in, duke kërkuar ndihmën e tij përfundimin e procedurave, mirëpo nuk është ofruar asnjë hollësi apo dëshmi.

## **III. ANKESAT**

7. Ankuesi pohon se ai dhe ish-kolegët e tij janë diskriminuar dhe se të drejtat e tyre themelore, siç është e drejta për t'u rikthyer në pozitat e tyre të punës janë shkelur.
8. Gjithashtu ai ankohet se ata janë injoruar dhe shpërfillur nga EULEX-i, i cili nuk ka arritur të shqyrtojë lëndën e tyre.
9. Ankuesi kërkon që ish-punëtorët e RTP-së duhet të kompensohen për humbjen e të ardhurave të tyre dhe kur është e mundur të kthehen në vendet e punës.

## **IV. LIGJI**

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin Ilogaridhëns të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me

rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standarde minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
13. Paneli konstaton se ankesat e ankuesit, në thelb kanë të bëjë me një kontest pune në mes të tij dhe RTP-së apo RTK-së. Rrjedhimisht ankesa e tij nuk bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Si pasojë, ato janë jashtë mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë (shih për shembull *Hamdi Sogojeva* kundër *EULEX-it*, nr. 2012-18, 6 qershori 2013, par. 7-8).
14. Për aq sa parashtresat e ankuesit mund të kuptohen si një ankesë rrëth rezultatit dhe kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore kundër RTK-së dhe AKP-së, Paneli rithekson se sipas rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ndikoj në rezultatin e procedurave gjyqësore apo shpejtësinë me të cilat ankesat në pritje shqyrtohen nga gjykatat e Kosovës. Për më tepër, Paneli tashmë ka konstatuar në shumë raste se edhe pse gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër shumë autoritete të tjera: E kundër EULEX-it, 2012-17, 30 gusht 2013, § 23; Gani Zeka kundër EULEX-it, 2013-15, 4 shkurt 2014, § 13).
15. Rrjedhimisht, kjo ankesë bie jashtë mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

**SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese